

VENDIM
Nr.535, datë 19.7.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.270, DATË 7.5.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KOMITETIT
SHTETËROR TË MINORITETEVE TË DISA MJEDISEVE, PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË KËTIJ KOMITETI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.270, datë 7.5.2004 të Këshillit të Ministrave, fjalët “Tre apartamentet...” të bëhen “Dy apartamentet...”, ndërsa fjalët “...apartamenti nr.9, 2+1, me sipërfaqe 65.9 m², shkalla I...” shfuqizohen.

2. Apartamenti i përmendur në pikën 1 të këtij vendimi të mbetet në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve të Trupit Diplomatik, në varësi të Ministrit të Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Fatos Nano

KRYEMINISTRI